

VENDIM
Nr. 602, datë 10.9.2014

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 459, DATË 23.9.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR PËR KULTET”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 459, datë 23.9.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime: Paragrafi i dytë, i pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komiteti Shtetëror për Kultet është institucion qendror, person juridik, në varësi të Kryeministrit.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Komiteti Shtetëror për Kultet përbëhet nga kryetari dhe pesë anëtarë. Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe anëtarët e këtij komiteti, të cilët propozohen nga kryetari, emërohen nga Kryeministri. Gjatë emërimit të përbërjes së Komitetit Shtetëror për Kultet, Kryeministri dhe kryetari i komitetit marrin parasysh dhe ruajnë parimet e asnjansisë shtetërore dhe të barazisë së bashkësive fetare, si dhe faktin që struktura e komitetit të reflektojë, realisht, identitetin dhe vlerat e bashkësive fetare.

Struktura, organika dhe rregullorja e veprimtarisë së Komitetit Shtetëror për Kultet miratohen nga Kryeministri, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama